



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR
SEKTORI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE DHE STREHIMIT

Nr. 3724 Prot

Maliq, më 22.6. 2021

LËNDA: Shpallje publike. *5724 me 1 ndalim*

**NJËSIVE ADMINISTRATIVE: MALIQ, POJAN, LIBONIK, PIRG, VRESHTAS,
MOGLICË, GORË**

NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” dhe VKM nr.384 datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” si dhe marrëveshjes me Entin Kombëtar të Banesave për ndërtimin e banesave me kosto të ulët, njoftojmë të gjithë të pa strehët e bashkisë Maliq se:, faza e parë e aplikimit për programin Banesë me Kosto të Ulët do të jetë e hapur deri më datë 21.09.2021, pas kësaj date do të fillojë faza e dytë e përzgjedhjes së përfituesve nga ky program.

-Banesë me kosto të ulët (BKU) konsiderohet banesa që plotëson të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi, që është e paracaktuar për t’u disponuar në pronësi nga përfituesi, nëpërmjet formave të ndryshme të lehtësimit nga institucionet shtetërore.

-Aplikimi për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, me përjashtim të rasteve të nevojës emergjente për strehim, bëhet me dy faza. Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e strehimit social, sipas ligjit nr. 22/2018. Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t’u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit.

-Përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët familjet me të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, sipas përcaktimit të nenit 2, pika 45, shkronja “a”, të ligjit 22/2018, të cilat, në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore:

a) vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekje apo sëmundje e rëndë) ose forcë madhore;

b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;

c) janë të zhvendosura nga banesat, sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij ligji.

- Kur përfitues është një familje që ka siguruar banesë nëpërmjet programeve sociale nga procesi i privatizimit ose nëpërmjet blerjes në tregun e lirë dhe sipërfaqja e banimit është nën normat e strehimit, bëhet shkëmbimi i banesës nën normë për të marrë një banesë në normat e nevojshme të strehimit, duke u llogaritur diferenca ndërmjet vlerës së banesës ekzistuese me vlerën e banesës me kosto të ulët që merr. Banesa ekzistuese nën normë bëhet pjesë e fondit publik të banesave dhe vihet në dispozicion të programit të banesave me kosto të ulët.

*Nr. 68 Prot
D. 21.06.2021*

KRYETARI BASHKISË
Gëzim Topciu

